



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 13
Prishtinë, më 12 maj 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 MAJ 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 89 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 5.maj 2011,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomik – Social,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kadastër.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ismet Beqiri, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi, Afrim Hoti, Arsim Bajrami, Xhevdet Neziraj, Glauk Konjufca, Zenun Pajaziti dhe Agim Kuleta, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me koston financiare të autostradës Vërmicë – Merdare.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Lama.

Deputetja Salihe Mustafa, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me asgjësimin e barnave me afat të skaduar.

Ministri Agani nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me lejimin e ndërtimit të spitaleve private në pronën e QKUK-së.

Ministri Agani nuk ishte prezent në sallë.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 5 maj 2011

Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të datës 5 maj 2011, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete.

Ministri **Slobodan Petroviq**, tha se Projektligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete ofron mundësi të mira në drejtim të përcaktimit të kushteve për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, si dhe përcakton format dhe mënyrat për realizimin e këtij bashkëpunimi.

Në vazhdim, tha se bashkëpunimi ndërkomunal i referohet dy apo më shumë komunave të cilat mund t'i bashkojnë burimet e tyre financiare në të mirë të ofrimit dhe të përmirësimit të shërbimeve komunale për qytetarët.

Më tutje, ministri Petroviq theksoi se struktura e Projektligjit është shumë e qartë dhe është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Jeton Sfirca, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Alma Lama, Arben Gashi, Zenun Pajaziti, Lutfi Zharku dhe Zv. kryeministri Hajredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 48,
Kundër-----24,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

Ministri **Dardan Gashi**, tha se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme rregullon regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe përfshin: regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, hipotekave, servitutet, të drejtën e shfrytëzimit për pronat publike dhe shoqërore, kompetencat e Agjencionit Kadastral të Kosovës dhe të zyrave komunale për kadastër.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re,

Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Myfera Shinik, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,

Kundër----- 7,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko – Social

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Këshillin Ekonomiko – Social.

Ministri **Nenad Rashiq**, tha se si çdo shoqëri në Evropën Juglindore, edhe shoqëria jonë po kalon nëpër rrethana jo të përshtatshme, në kuptim të çështjeve sociale.

Në vazhdim, tha se qëllimi kryesor i këtij Projektligji është krijimi i infrastrukturës ligjore për funksionimin e Këshillit Ekonomiko – Social, si një mekanizëm shumë i rëndësishëm për funksionimin e politikave të punësimit dhe çështjeve sociale.

Më tutje, ministri Rashiq theksoi se Projektligji rregullon funksionimin e Këshillit Ekonomiko – Social, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Këshilli, kriteret për kyçjen e organizatave të ndryshme në Këshillin Ekonomiko – Social etj.

Në përfundim të ekspozesë së tij, ministri u fokusua në disa çështje që kanë të bëjnë me: funksionimin e Këshillit të deritanishëm dhe strukturën e tij, nivelin e pagës minimale në Kosovë, etj.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Këshillin Ekonomiko – Social.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Aurora Bakalli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Ramiz Kelmendi, Sali Asllanaj, Lutfi Zharku dhe Visar Ymeri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,

Kundër----- 5,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Këshillin Ekonomiko – Social.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal në Kosovë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për organizimin sindikal në Kosovë.

Ministri **Nenad Rashiq**, tha se aktualisht në Kosovë kjo lëmi rregullohet me Ligjin e Punës. Liria e organizimit sindikal është liri themelore e njeriut, e njohur kudo në botë. Në vazhdim, tha se qëllimi i këtij Projektligji është organizimi sindikal i punëtorëve, mbrojtja e të drejtave të punëtorëve dhe eliminimi i diskriminimit të tyre. Më tutje, ministri Rashiq theksoi se ky Projektligj adreson shumë çështje nga fusha e të drejtave të të punësuarve për themelimin e një sindikate të lirë dhe të ligjshme, siç janë: sigurimi i të drejtës për t’iu bashkangjitur sindikatës, sipas zgjedhjes së punëtorit, mos ndërhyrja në çështjet e themelimit dhe veprimit sindikal, krijimi i kushteve për veprim optimal sindikal dhe respektimin e legjislacionit në fuqi. Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për organizimin sindikal në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Aurora Bakalli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Lumnije Morina dhe Visar Ymeri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për organizimin sindikal në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për mbrojtje nga zjarri.

Në emër të Qeverisë prezantimin dhe arsyetimin e Projektligjit e paraqiti ministri Bedri Hamza.

Ministri **Bedri Hamza**, tha se miratimi i këtij Projektligji do ta shfuqizonte Ligjin në fuqi, edhe për faktin se zjarrfikja dhe shpëtimi do të trajtohen nga aspekti juridik me një ligj të veçantë.

Në vazhdim, tha se ky projektligj është harmonizuar me rrethanat e reja të krijuara në Kosovë. Projektligji përmban 8 kapituj me 41 nene.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtje nga zjarri.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fadil Demaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Ismet Beqiri dhe Zenun Pajaziti, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----51,

Kundër-----15,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtje nga zjarri.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Ministri **Bedri Hamza**, tha se kjo fushë aktualisht rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/30, ndërsa në Projektligjin të cilin po e shqyrtojmë sot, janë marrë parasysh direktivat e legjislacionit evropian, madje ato të vitit 2010, nga kjo fushë.

Në vazhdim, tha se ky Projektligj rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kosovar për raportim financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesional, licencimin e auditorëve, etj.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputeti, Lutfi Zharku, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,

Kundër----- 4,

Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kadastrë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për kadastrë.

Ministri **Dardan Gashi**, tha se Projektligji për kadastrë rregullon formimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale dhe krijon parakushte për regjistrimin e të drejtave, ngarkesave, barrave të ndryshme për njësitë kadastrale, etj.

Në vazhdim, tha se Ligji në fuqi për kadastrin është miratuar në vitin 2003, dhe tani shtrohet nevoja e një Projektligji të ri, çfarë e kemi sot, i cili është si rezultat i zhvillimeve të reja tekniko-teknologjike në lëmin e instrumenteve bashkëkohore të gjeodezisë dhe avancimin e metodave të matjeve kadastrale.

Projektligji për kadastrë është i harmonizuar me legjislacionin evropian nga kjo fushë, theksoi ministri Gashi.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për kadastër.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Imri Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivković, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Kadastër.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:52 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale